



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 93, datë 10.04.2020

**PËR KONTRIBUTIN FINANCIAR TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT  
TË LARTË TË PROKURORISË NË KUADËR TË GJENDJES SË  
FATKEQËSISË NATYRORE TË SHPALLUR NË VEND**

Mbështetur në nenin 149/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 164/8, 166/2, 189 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore shpallur me vendimin nr. 243, datë 24/03/2020, të Këshillit të Ministrave, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për muajin prill do të dhurojnë në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.
2. Ngarkohet drejtoria e financës e KLP-së për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave për derdhjen e fondit të dhuruar në buxhetin e shtetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.



**KRYETARI  
GENT IBRAHIMI**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**